

## Informacion per Mjedisin;

Ne zbatim te ligjit nr.10431 date 09/06/2011"Per Mbrojtjen e Mjedisit", ligjit 8503 date 30.06.1999 "Per te drejten e Informimit per dokumentat zyrtare"Zonat e mbrojtura ne Qarkun e Dibres jane;

### ➤ 1.Parku Kombetar i Lures (kategori e II, VKM nr.96. date 21.11.1996)

Parku kombetar I Lures konsiderohet si nje nga perlat e natyres shqiptare, shtrihet ne faqen lindore te masivit "Kurora e Lures" dhe ka nje siperfaqe faktike kadastrale prej **1043 ha**, nga e cila **812.6 ha** pyje, **49.8 ha** livadhe, **153.8ha** siperfaqe inproduktive shkembore dhe **26.7 ha** pasqyra e ujit te liqenit.

**Flora** dhe **Fauna** e ketij parku eshte shume e pasur, aty rriten ahu, pisha e zeze, rrobulli, bredhi, dushqet etj.

Parku kombetar i Lureska filluar te demtohet pas viteve 1991 e ne vazhdim. Prerjet e pergjithshme dhe abusive vecanerishte ne periudhen 1997-2001, kane demtuar strukturen e pyjeve, llojin e drureve, duke shkateruar siperfaqet e konsiderueshme te populluara nga pyje dhe drure te ndryshem.

Zjarret e shpeshta qe kane rene ne keto zona kane ndikuar shume ne perkeqesimin e gjendjes se pyjeve ne kete park si edhe ne rrezikimin pakesimit te shume habitateve. Kullotja e bagetive Brenda territorit dhe gjuetia e paligjshme qe eshte jashte kontrollit e kane demtuar rende faunen.

### ➤ 2.Rezervati I luznise-Bulacit

(kategoria e VI, VKM nr.102 date 15.01.1996)

Ky rezervat ka nje siperfaqe prej **5900 ha**.dhe perbehet nga massive pyjore te dushkut. Ai perbehet kryesishte nga pyje te shparthit(quecus cerris) dhe bungebutes(quecus pubescens), ndersa bimesia barishtore dhe ajo e ahishteve natyrore.Rezervati ka filluar te demtohet rende pas vitit **1991** nga nderhyrjet e paligjshme te popllates.Gjendja e ekosistemeve dhe ehabiteteve vleresohet si shume e demtuar megjithse vitet e fundit ka pasur permirsime te dukshme. Prerjet abusive, kullotja e te imtave, gjuetia e pakontrolluar dhe erozioni I tokes kane sjelle degradim te pyllit.

- **3.Vlashaj** (Monument natyre kategoria e III, VKM nr. 102 date 15.01.1996)

Monumenti Vlashaj perfshine dy ngastra te ekonomise pyjore “Krej-Lure, Armolle” me nje sip.prej **50 ha**. Ne kete zone deri ne vitin 2005 pervec demtimeve massive nga zjarret ka pasur demtime edhe nga prerjet e paligjshme ku mbi 90% e drureve kane qene djegur dhe prere nga fshataret. Me demtimet qe ka pasur kjo zone ka vite qe nuk mund te quhet me zone e mbrojtur ne kuptimin e mirfillte te fjales.

- **4.Zall-Gjocaj MAT** (kategoria e II, me sip.140 ha, vlere te madhe estetike, turistike dhe peisazhore)Bize-Martanesh (kategoria e V, VKM nr.49 date 31.07.2007)
- **Liqeni I Ulzes** (katgoria IV, sip.4206ha, VKM nr.16, date 30.04.2013)
- **Mali I Korabit** (kategoria e IV, sip.20.663ha, VKM nr898 date 21.12.2011)
- **Shebenice-Jabllanice** (kategoria II, sip.167.6 ha, VKM nr 640, date 21.05.2008)

## Parandalimi i ndotjeve

### 1.Monitorimi icilesise se ajrit

Ne pergjithesi nuk monitorohet cilesia e ajrit ne qytetet Peshkopi, Burrel dhe Bulqize si edhe tek subjektet qe shkaktojne ndotje ajri, perjashtuar uzinen e FE-Cr.

Institucionet rajonale te certifikuara, si drejtoria Rajonale e Shendetesise Diber, per mungese aparaturash nuk e realizon monitorimin e ajrit.

Faktoret kryesore te ndotjes se ajrit jane shkarkimi i gazeve nga makinat e vjetra, cilesia e lendeve djegese qe perdoret per automjetet, e cila ne Shqiperi eshte me e ulet se ato te vendeve te BE-se, infrastruktura ne ndertim e cila rrit pluhurin ne ajer si edhe djegia ne disa raste te mbeturinave urbane.

Ne shkalle qarku jane identifikuar rreth 6873 automjete te kategorive te ndryshme.

Ndihet nevoja e politikave te vecanta afat gjata per uljen e ndotjes nga shkarkimet e automjeteve, cilesise se naftes dhe parandalimit te diegieve te mbetjeve.

**Zhurmat:** Ne rajonin e Qarkut Diber, ndotja akustike nuk krijon problem shqetesues per mjedisin.

### Flora:

Vitet e fundit Agjensia rajonale e mjedisit dhe drejtoria e pyjeve eshte monitoruar grupi I specieve te cilat konsiderohen:

- Te zhdukura
- Te zhdukura ne gjendje spontane
- te rrezikuara ne menyre kritike.

Sipas librit te kuq 1995 konsiderohet ne menyre kritike 1.**Gymnospermium scipetarum(lulehelmi) paparisto dhe qosja** (scipetarum) e cila ndodhet ne malin e shalqinit ne Martanesh.

2.**Quercus robur L(rrenje)** ne gjendje te perkeqesuar e cila ndodhet gjate rrjedhes se lumit Mat.

3.**Viola dukadjinica E Beeker et kasani9n(Manushaqe e Dukagjinit) e cila paraqet rrezik te ulet dhe ndodhet tek Teqja e Martaneshit, Kurore Lure.**

**Pyjet:**

Qarku I Dibres dallohet per pasuri te medha pyjore. Pyjet zene rreth **66% te** siperfaqes se ketij Qarku dhe ajo eshte **3.2** here me e madhe se siperfaqja e tokes arre, gje e cila tregon se fondi pyjor ka potencial te rendesishem mjedisor dhe ekonomik.

<b>Rrethi</b>	<b>Pyje Siperfaqe ha</b>	<b>Vellimi (000m3)</b>	<b>Nga keto produese: Sip.ha</b>	<b>Vellimi (000m3)</b>	<b>Livadhe Kullota</b>
Diber	34193	3206	24300	2442	12899
Mat	44240	4934	42090	4694	6411
Bulqize	36510	3655	28790	3355	371
Qarku ne total	1140943	11795	95180	10471	19681

Relievi dhe Klima e Qarkut Diber bejne te mundur qe aty te ndodhen te gjitha katet bimore te vendit tone duke filluar nga shkurret mesdhetare deri ne livadhet alpine.

Brezi i dushkut shtrihet deri ne lartesine 800m mbi nivelin e detit dhe perbehet nga druret e qarrit (quercus cerris), shparthit (quercus fraineto). Kyeshte brezi me I demtuar nga nderhyrjet e popullsise lokale pasi aty sigurohen druret e zjarrit, kullotja e bagetive.

Ne lartesine 900 deri ne 2000m mbi nivelin e detit shtrihet brezi I ahut. Ky eshte demtuar kryesishte per sigurimin e lendes drusore massive, si pasoje ne shume zona kane mbetur vetem njolla te vogla te ahishteve te vjetra, kryesishte ne vendet e izoluara e te papershkruara nga rruget si ne Bulqize, liqenet e Bulqizes, gryke sete, Vlashaj etj. Ne brezin e ahut rriten ne formacione halore si pisha e zeze (pinus nigra), ne zona te tilla si Martanesh, Kraste, Ternove, Lure, Kacni.

Ne pjesen e sipërme te brezit te ahut mbizoterojne pyjet e Robullit, vecanersishte ne Korab, Sllatine, Deje dhe Martanesh.

Pas viteve 90, ne qarkun e dibres pyjet kane pesua demtime te ndjeshme.

Demtimet me te medha jane si pasoje e kullotjeve dhe prerjeve abusive te tyre.

Investimet per riparteritjen e pyjeve kane qene te pakta krahasuar me nevojat.

## **TOKA**

### **Erozioni dhe shkarjet e tokes;**

Ndertimi gjeologjik I shtresave, pjerresia, rreshjet, mbikullotjet, mosmenaxhimi I ujrave nentokesoredhe siperfaqesoresi edhe shume faktore te tjere objektive subjektive kane ndikuar shume ne pranine e ketije fenomeni shkaterues per token ne qarkune Dibres.

Erozioni dhe shkarja e tokes me problematike ka qene ne zonen e Burrelit, Bushkashit te rrethit Mat, ne zonen pyjore luzni-laç. Nje fenomen tjetër që ndikon ne erozionin e tokes ka te beje me gerryerjen e tokes ne brigjet e lumenjeve si rezultat I shfrytezimit te inerteve lumore nga subjektet me ose pa leje mjedisore, ne basenin e lumit Drin dhe Mat.

### **MBETJET:**

Rritja dhe permiresimi i gjendjes ekonomike dhe menyres se jeteses ka sjelle rritje te konsiderueshme mbetjeve urbane ne qytete dhe zona rurale.

Administrim i ketyre mbetjeve persa I perket pastrimit dhe venddepozitimit te tyre lene shume per te deshruar.

Ne rrethet mat dhe Bulqize si rezultat I mungeses se landfilleve mbeturinat hidhen ne vende te papershtatshme dhe te pa miratuarq, duke shkaktuar problem shqetesuese per komunitetin e ketyre zonave.

### **Mbetjet spitalore:**

Perbejne nje problem te madh ne mbrojtjen e mjedisit.Spitalet dhe qendrat shendetesore nuk kane vende te pershtatshme per asgjesimin e ketyre mbetjeve, por aro hidhen sebashku me me mbetjet e tjera urbane ne vendet e grumbullimit te caktuar nga pushteti vendor.

### **Mbetjet e vajrave:**

Njesite e qeverisjes vendore duhet te identifikojne subjektet private qe mund te jene te interesuara ne grumbullimin dhe riciklimin e kesaje rryme dhe jashte njesise ne te cilen ndodhen dhe te provojne me tej grumbullimin e diferencuar te kesaje rryme.

### **Cilesia e ujrave siperfaqesore dhe nentokesore:**

Monitorimet e bera tregojne se ujrat nentokesore ne basenin e drinit kane veti fiziko kimike te mira, jane neutral dhe alkanile, jane ujra te embla me fortessi mesatare deri te forte, permbajtja e mikroelementeve eshte Brenda normave te lejuara.

Sipas konfirmimeve nga laboratorit kimik prane Drejtorise se Shendetit Publik Diber, rezulton se

Uji i pijshem eshte ne kufijte e normales persa I perket tejdukshmerise, temperatures, shijes, temperatures e **Ph**, nuk ka sendimente dhe bakteret jane te pakta.Ne ujin e pijshem mungojne komponimet toksike, por megjithate ka raste ku jane diktuar komponime te **Pb**, te cilet krijohen si rezultat I tubacioneve metalike.

Monitorimi I ndikimit te shkarkimeve te lengeta urbane tregojne per nje ndikim te qendrueshem. Mungojne impiantet e perpunimit te ujrave te zeza, Derdhjet e ujrave te zeza te qyteteve Burrel, Bulqize dhe Peshkopi, behen large qendrave te banuara dhe pastaj ne lumenjte dhe perrenjte qe pershkojne Qarkun Diber.